



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK**

**Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Blerje pllaka dhe bordura”**

I mbajtur sot në datë 15.10.2024 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pllaka dhe bordura”, me fond limit 26,870,750 (njëzet e gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH 271971,2 (dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pike dy) euro pa TVSH, bazuar në kursin e këmbimit date 15.10.2024 (1 Euro= 98.80).

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

**Së pari**, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, mirëmbajtjen pllakave dhe trotuareve. Blerja e pllakave dhe bordurave ka si qëllim përmirësimin e trotuareve si dhe zëvendësimin e pjeseve të ndryshme perberes. Problematikat kanë natyrë të perseritur. Si rrjedhim, pjesa dermuese e këtyre mallrave janë komplementarë të njeri tjetrit, që do të thote instalohen apo montohen njëkohësisht dhe në mënyrë paralele në një sistem trotuaresh dhe furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe

referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash, komplementare të njëra-tjetrës, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**